



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 10**

Datë: 20. 02. 2020. Ora: 15:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

**RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Aktivitetet e ZRPP-së;**

Rekomandim për certifikimin e kandidateve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar Komune në Podujevë,
- 3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**
  - **Këshilli për Operacionet Zgjedhore**
    - Shqyrtimi dhe miratimi i formulës së Këshillave të Vendvotimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës,
- 4. Të ndryshme**

## **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KOZ-së**

**Vadete Daka:** Kush është për këtë rend dite...? Nëse nuk ka askush, a e miratojmë...? Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

### **2Aktivitetet e ZRPP-së:**

Rekomandim për certifikimin e kandidateve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar Komune në Podujevë

**Yll Buleshkaj:** Zyra, ka shqyrtuar dhe miratuar tri kandidaturat e ardhura. Nga:

**LDK** – Nexhmi Rudari

**Lëvizja “Vetëvendosje”** – Shpejtim Bulliqi

**PDK** - Naim Fetahu

Sipas autorizimeve ligjore, dokumentacionin është në rregull, dhe ne rekomandojmë certifikimin e këtyre kandidatëve. I keni draft – vendimet. Pra, siç e kërkon legjislacioni, dokumentacion është në rregull.

**Valdete Daka:** Pra, t’i certifikojmë me radhë...!

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan kandidatët e subjekteve politike që do të garojnë për kryetar Komune në zgjedhjet e jashtëzakonshme në Podujevë.

Kwta janw: **LDK** – Nexhmi Rudari, **Lëvizja “Vetëvendosje”** – Shpejtim Bulliqi, dhe **PDK** - Naim Fetahu

## **5. Raporti i Këshillave të KOZ-së:**

Këshilli për Operacionet Zgjedhore

*Shqyrtimi dhe miratimi i formulës së Këshillave të Vendvotimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës,*

**Alim Rama:** Këshilli, ka shqyrtuar propozimin e Sekretariatit për Këshillat e Vendvotimeve. Duke marrë për bazë që janë vetëm tre kandidatë, në bazë të rregullores dhe ligjit, këshilli rekomandon që të nominohen nga dy përfaqësues të këtyre tri subjekteve politike.

**Eshref Vishi:** Mendoj që nuk është propozuar formula adekuate e cila do të siguronte integritet dhe gjithë përfshirje në këtë proces zgjedhor sa u përket trupave menaxhuese zgjedhore, apo këshillave të vendvotimeve. Ne si subjekt politik, nuk garojmë me kandidat, por jemi të gatshëm të jemi pjesë e procesit. Ka hapësirë për përfshirjen edhe të subjekteve të tjera në këshillat e VV-e, dhe kur dihet se KVV-të janë pjesë për sigurimin e integritetit, të sigurisë dhe qetësisë në procesin e votimit dhe të numërimit të votave.

**Mendoj, tha z.** Vishi se, interesimi për mbarëvajtje të integritetit zgjedhor është i të gjithëve, dhe jo vetëm i subjekteve që garojnë, prandaj KOZ është dashur ti ketë parasysh këto kritere ! Unë propozoj që kjo ka hapësirë të shqyrtohet, dhe këshilli ta gjej një formulë tjetër. Në të kundërtën, vota ime do të jetë kundër.

**Sami Hamiti:** E kemi analizuar këtë gjatë në KOZ, madje edhe nga praktika. Besoj e dini se të drejtë nominimi për anëtar të KVV-e kanë subjektet pjesëmarrëse në Kuvendin e Kosovës që, edhe janë këto tri subjekte që marrin pjesë në zgjedhje, dhe që janë të përfaqësuara edhe në Kuvendin Komunal, e që po ashtu janë këto tri subjekte...

KQZ, e bënë një formulë dhe, këto tri subjekte e ruajnë integritetin e zgjedhjeve pa problem... Pra, ne kemi praktika... Unë, mbes në qëndrimin që e kemi marrë në KOZ...

**Eshref Vishi:** Përfaqësimi adekuat i subjekteve politik garues është me një anëtarë në KVV, dhe jo me këtë formulë...

**Sami Hamiti:** T'i nuk je në garë, dhe nuk mund të marrësh pjesë si subjekt...

Në këtë pikë, debatuan në vazhdim: Alim Rama, Eshref Vishi, Sami Hamiti dhe Valdete Daka.

**Valdete Daka:** Ne, e kemi një rekomandim ! Unë, e hedh në votim rekomandimin e KOZ-it me këtë formulë: kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, me nëntë vota për, dhe një votë kundër (Eshref Vishi), anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.